



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI BASHKIAK

**KOMISIONIT TË BUJQËSISE, PYJEVE, MENAXHIMIT TË UJRAVE, TURIZMIT,
MBROJTJES SË MJEDISIT**

Nr. 985 prot.

Fushë-Arrëz, më 27. 03. 2026

PER : KESHILLIN E BASHKISE

FUSHË-ARRËZ

Relacion i Komisionit të Bujqësisë, Pyjeve, Menaxhimit të Ujrave, Turizmit, Mbrojtjes së Mjedisit mbi Projektvendimin për miratimin e planit të masave për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në pyje dhe kullota, si dhe për krijimin e njësisë vullnetare të shuarjes së zjarreve për vitin 2026 në Bashkinë Fushë-Arrëz.

Ne zbatim të ligjit 139/2015 “Per veteqeverisjen vendore”, i ndryshuar, u mbledh Komisioni i Bujqësisë, Pyjeve, Menaxhimit të Ujrave, Turizmit, Mbrojtjes së Mjedisit (Mustaf Pashkaj, Nikolin Sadikaj, Pavlin Qafa) ditën e premte, datë 27.03.2026, ora 11:30, në sallën e mbledhjeve të Këshillit me pjesëmarrjen e Mustaf Pashkaj e Pavlin Qafa ku u mor ne shqyrtim Projektvendimi lidhur me planin e masave për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në pyje dhe kullota për vitin 2026, në territorin administrativ të Bashkisë Fushë-Arrëz.

Ne mbledhje per shpjegimin e projektvendimit ishte Z. Ardmir Doda, Drejtor i Administrimit te Pyjeve dhe Kullotave:

Në kuader të marrjes së masave për parandalimin e rënies së zjarrëve në pyje dhe kullota në territorin administrativ të Bashkisë Fushë-Arrëz, Drejtoria e Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave për vitin 2026 në këto plan masash do gjejnë vend veprimet e domosdoshme për parandalimin e rreziqeve nga zjarri, veprimet për zbulimin e shuarjen e zjarreve dhe për rehabilitimin e sipërfaqeve të demtuara nga zjarri, dhe konkretisht:

1. Ngritja e shtabit pranë Bashkisë Fushe-Arrez për parandalimin dhe menaxhimin e zjarreve në pyje dhe kullota. Drejtoria e Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave, deri me date 16.05.2025.

2. Organizimi i sistemit të vrojtimit - sinjalizimit, i cili funksionon gjatë gjithë vitit në shkallë të ndryshme gadishmërie, në varësi të sezonit të zjarreve, dhe në nivel njësie administrative.

Drejtoria e Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave, në bashkëpunim me administratorët dhe kryetarët e fshatrave, deri me datë 23.05.2025.

3. Organizimi i njësive vullnetare të shuarjes së zjarreve (NJVSHAZ), me 5-15 vullnetarë, për çdo fshat të cilët veprojnë gjatë periudhës 1 maj - 15 tetor.

Njësitë administrative në bashkëpunim me kryetarët e fshatrave deri me datë 23.05.2025.

4. Planifikimi, shpërndarja dhe përdorimi efektiv i burimeve njerëzore e i mjeteve motorike, i fikseve të shpinës, veshmbathjeve të posaçme kundra zjarrit dhe veglave të punës në dispozicion dhe administrim të çdo njësie administrative.

Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Financës dhe Tatim Taksave dhe Drejtoria e Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave deri me datë 23.05.2025.

5. Personat përgjegjës të sektorit të pyjeve, të emergjencave civile dhe të shërbimit zjarrfikës në bashkëpunim me administratorët e njësive vendore si dhe personat përgjegjës të institucioneve të tjera, planifikojnë organizimin e takimeve për informimin dhe ndërgjegjësimin e publikut, në shkolla dhe institucione të tjera shtetërore dhe private, për rrezikun e zjarreve dhe mbrojtjen nga zjarri, duke u përqendruar në:

a) Ndalimi në largësi 200 - 300 metra, e ndezjes së zjarreve në pyje e kullota ose jashtë tyre, që rrezikon djegien e pyllit ose të kullotës.

b) Ndalimin e tymosjes së bletëve në pyje e kullota, përveç kur ky veprim kryhet me mjete që kanë pajisje të posaçme dhe kapak plotësisht të mbyllur.

c) Mbajtjen nën kontroll të vizitorëve, ekskursionistëve, grupet sportive, gjatë vizitave të tyre në pyje dhe kullota, të blektorëve që shfrytëzojnë kullotat verore, si dhe të subjekteve apo individëve që punësohen në shfrytëzimin e lëndës drusore dhe të produkteve të tjera me origjinë pyjore.

c) Ndalimin e përdorimit të tapave të fishekëve të gjahut prej materiali që merr zjarr lehtë (lini, letër, peceta etj.).

d) Ndalimin e djegies së kashtës së të korrave të kulturave bujqësore që rrezikojnë përhapjen e zjarreve në pyje dhe kullota, pa marrjen e masave parandaluese.

dh) Ndalimin e qitjeve me predha që shkaktojnë zjarr në zonat me drurë pyjorë të thatë dhe mbeturina pyjore (gjethe, shkarpa, kalbësira etj.) e në kullota.

ë) Mbajtjen në gatishmëri të sistemit të lajmërimit dhe mjeteve të komunikimit.

f) Rëndësinë e raportimit në vazhdimësi për situatën në raste zjarresh, sipas linjës së varësisë.

Specialistët, Rojtarët e pyjeve, Inspektorët, përkatës vazhdimisht.

6. Organizimi i provave të gatishmërisë për të verifikuar skemat e lajmërimit, grumbullimin e njerëzve, gadishmërinë e mjeteve dhe sistemeve të ndërlidhjes e të komunikimit.

Personi përgjegjës pranë njësive vendore dhe kryetarët e fshatrave, një provë deri me datë 13.06.2025.

7. Specialistët e shërbimit pyjor, të emergjencave civile dhe të shërbimit zjarrfikës, me mbështetjen e administratorit të njësisë vendore dhe kryetarëve të fshatrave, organizojnë trajnime dhe kualifikime të punonjësve të NJVSHZ - ve, për shuarjen e zjarreve.

Përgjegjësit, specialistët, inspektorët, rojat e pyjeve përkatës vazhdimisht.

8. Përgatitja dhe vendosja në dukje në vende të dukshme, të tabelave të posaçme me njoftime për mbrojtjen e pyjeve dhe kullotave nga zjarri.

Inspektorët, rojat e pyjeve përgjegjës pranë njësive administrative deri me datë 16.05.2025.

9. Administratorët e njësive administrative dhe pronarët privatë të pyjeve ngrejnë infrastrukturën për mbrojtjen nga zjarri dhe raportojnë vazhdimisht mbi mbarëvajtjen e këtij procesi në strukturat përgjegjëse të Bashkisë Fushë-Arrëz.

10. Shpenzimet për funksionimin dhe përmirësimin e infrastrukturës për shuarjen e zjarreve në fondin pyjor dhe kullosor, si dhe për ngritjen e njësive vullnetare të shuarjes së zjarreve (NJVSHAZ) përballohen nga personat juridikë dhe/ose fizikë, që i kanë në pronësi/përdorim, në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga ligji “Për emergjencat civile”.

Personat përgjegjës për financat e sektorit të pyjeve pranë bashkisë deri me datë 23.05.2025.

11. Nën linjat e tensionit të lartë që kalojnë në pyje dhe kullota, krijohet një trase me gjerësi 20-30 metra, e cila pastrohet vazhdimisht nga drurët dhe mbulesa vegjetative, për të shmangur zjarret dhe aksidentet e mundshme nga defektet dhe këputjet e linjave. Punimet për hapjen dhe mirëmbajtjen e traseve bëhen në bazë të një projekti teknik, që hartohet nga specialistë të licensuar të fushës dhe miratohet nga Bashkia Fushë-Arrëz, e cila ndjek dhe zbatimin e projektit. Shpenzimet dhe përgjegjësinë për kryerjen e kësaj operacioni i ka sektori përkatës i OST-së ose administruesi i linjës.

Administratori dhe inspektorët, rojat e pyjeve përgjegjës pranë drejtorisë së pyjeve, vazhdimisht.

12. Në anët e rrugëve nacionale dhe rurale që kalojnë në afërsi të pyjeve, ndërmarrjet e mirëmbajtjes së rrugëve marrin masa pastrimi skarpate të rrugëve nga vegjetacioni i dendur me qëllim parandalimin e zjarreve.

Personi përgjegjës për pyjet dhe personi përgjegjës për rrugët rurale, vazhdimisht.

13. Djegia e kullotave të infektuara nga barërat e këqija dhe parazitët bëhet me miratimin me shkrim të Drejtorisë së Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave, sipas nenit 22 të ligjit nr.9693, datë 19.3.2007, “Për fondin kullosor”, të ndryshuar.

Personi përgjegjës për pyjet dhe kullotat pranë drejtorisë, vazhdimisht.

14. Ndezja e zjarreve në brendësi të zonave të mbrojtura bëhet vetëm në zona të përcaktuara nga administrata e këtyre zonave, pasi të jenë marrë masat e nevojshme për krijimin e kushteve të përshtatshme që parandalojnë përhapjen e zjarrit.

Specialistët e sektorit pyjor, rojtaret e pyjeve, inspektorët e kontrollit të territorit dhe policia bashkiake, vazhdimisht.

15. Gjatë operacioneve të parandalimit e të shuarjes së zjarreve në pyje dhe kullota, në të cilat ka banesa ose objekte të tjera civile, njësitë e qeverisjes vendore, personat fizikë dhe juridikë, publikë dhe privatë dhe organet e shërbimit pyjor bashkëpunojnë me Policinë dhe Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimin, duke shkëmbyer informacione dhe burime njerëzore e materiale, sipas nevojave respektive dhe mundësive reale. Në këtë kontekst kërkohet plan veprimi i përbashkët ndërmjet këtyre strukturave.

Përgjegjësi i shërbimit zjarrfikës, përgjegjësi i sektorit pyjor dhe administratorët e njësive administrative, deri më datë 23.05.2025.

16. Për shuarjen e zjarreve të mëdha marrin pjesë me forca dhe mjete, sipas kapaciteteve që kanë në dispozicion, të gjitha institucionet shtetërore dhe private, njësitë e reparteve ushtarake etj. Në këto raste, shuarja e zjarrit organizohet e kryhet sipas kërkesave dhe procedurave të përcaktuara në ligjin “Për emergjencat civile” dhe në aktet nënligjore, në zbatim të tij.

17. Në rastet kur është e nevojshme vendimmarrja për zgjidhjen e situatave konkrete, drejtimi organizativ dhe teknik i operacionit për shuarjen e zjarreve në pyje dhe kullota bëhet nga specialisti i pyjor, përgjegjës për zjarret.

18. Sektori i Menaxhimit të Pyjeve, specialistët, inspektorët, rojtaret e pyjeve përgjegjës pranë njësive administrative, shërbimet e policisë bashkiake, inspektorati i kontrollit të territorit, dhe ato të shërbimit zjarrfikës, mbajnë kontakte të vazhdueshme me strukturat e policisë dhe strukturat e tjera ligjzbatuese, ku krahas kontributit për sensibilizimin e komunitetit për marrjen e masave për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në pyje dhe kullota, marrin të gjitha masat për zbulimin, gjetjen dhe vënien përpara përgjegjësisë ligjore të personave zjarrvënës.

Specialistët, inspektorët, rojtaret e pyjeve, përgjegjës për zonën pyjore, Shërbimit zjarrfikës, Inspektorati i Kontrollit të Territorit dhe Policia Bashkiake – vazhdimisht.

19. Strukturat përgjegjëse të administrimit të fondit pyjor dhe kullosor pranë bashkisë hartojnë një plan-veprimi të përbashkët me strukturat e shërbimit zjarrfikës, për raste kur do të përdoren forcat zjarrfikëse dhe mjetet e tyre në operacionet izolimit dhe fikjes së zjarreve në zonat pyjore me rrezikshmëri të lartë.

Përgjegjësi i sektorit të pyjeve dhe ai i shërbimit zjarrfikës, deri më datë 13.05.2025.

20. Në buxhetin vjetor për sektorin e pyjeve dhe kullotave planifikohet një fond operativ për mbrojtjen e pyjeve dhe të kullotave nga zjarri, për:

a) organizimin dhe funksionimin e përhershëm të sistemit të analizës së të dhënave për përcaktimin e rasteve të vendimmarrjes për të ardhmen, si dhe për mbajtjen e skuadrave zjarrfikëse pranë organeve të shërbimit pyjor dhe qeverisjes vendore;

b) organizimin e sistemit të vrojtimit/sinjalizimit në të gjithë territorin e bashkisë Fushë-Arrëz, për fushatat e sensibilizimit dhe të ndërgjegjësimit të publikut për rrezikun e zjarreve në pyje dhe kullota;

c) kryerjen e punimeve të nevojshme për parandalimin e zjarreve dhe reduktimin e pasojave të tyre (pastrime, rrallime, hapje brezash, kulla vrojtimi etj.);

ç) eliminimin e pasojave të zjarreve (hedhje fare, mbjellje, punime për frenimin e erozionit etj.);

d) shpërblimin e të aksidentuarve në rastet e pjesëmarrjes në shuarjen e zjarreve në pyje;

e) dhënien e stimujve material për rastet e kontributeve të veçanta për këtë qëllim;

ë) përmirësimin e logjistikës me mjete e pajisje dhe të infrastrukturës mbështetëse në përgjithësi.

21. Mënyra e pagesës dhe e shpenzimeve për shuarjen e zjarreve në pyje dhe kullota bëhet sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, që përcaktojnë mënyrën e lëvrimin të fondeve në rastet e emergjencave civile.

Personat përgjegjës, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Financës dhe Tatim Taksave e bashkisë Fushë-Arrëz deri më 23.05.2025

22. Për zbatimin e këtij plan masash, ngarkohen Drejtoria e Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Tatim Taksave, Shërbimi Zjarrfikës pranë Bashkisë Fushë-Arrëz dhe Njësitë Administrative etj.

23. Me këtë plan masash, njihen dhe pajisen me nga një kopje të gjitha strukturat në varësi të Bashkisë Fushë-Arrëz.

Ardmir Doda, Drejtor i Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave, kërkon komisionit që ta miratojmë projektin dhe t'a kalojmë për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen plenare të keshillit bashkiak të datës 30.03.2026

Pavlin Qafa, anetar i komisionit thotë se unë jam dakord me projektin.

Mustaf Pashkaj ve theksin në korrektesinë e zbatimit të këtij projekti.

Komisioneret rane dakord me shumice votash duke e derguar projektin per shqyrtim dhe miratim ne mbledhjen e dates 30.03.2026.

Duke kerkuar bashkepunimin tuaj!

Parlimentar
Pamir

PER KOMISIONIN

Mustaf Zekaj
M. Z.